



N.SH. "Univerzum Audit"

KRM "PASTRIMI" SH.A.

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare
për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2014**

P ë r m b a j t j a

-Raporti i auditorit të pavarur	4
-Informata të përgjithshme rreth kompanisë.....	7
-Pasqyrat financiare.....	6
-Pasqyrat e politikave kontabël dhe shpalosjet financiare.....	15-26
-Fushëveprimi , Objektivat dhe shtrirja e auditimit.....	27

Shkurtesat e përdorura:

SNA- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

SNK- Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

SKK- Standardet Kosovare të Kontabilitetit

ATK- Administrata Tatimore e Kosovës

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR **Për bordin e drejtorëve të KRM "PASTRIMI" Sh.A.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të KRM "PASTRIMI" Sh.A. (më tej referuar si "Kompania"), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2014, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parash për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare që janë të lira nga gabimet materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit dhe bërjen e vlerësimeve të kontabilitetit që janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në kryerjen e auditimit. Për shkak të çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për kualifikim të opinionit, ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe planifikojmë e kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga ndonjë gabim material. Auditimi përfshinë procedurat e kryerjes për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen në gjykimin e auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë mashtrim ose gabim. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të riskut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të Kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga Menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë të auditimit.

Opinion i pa kualifikuar

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjes së theksuar në paragrafin në vijim, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2014 dhe performansën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe SNA.

Theksim i çështjes

Duke mos e kualifikuar mendimin tonë, ne tërheqim vëmendjen për çështjet si në vijim:

Pas kontroleve të përfunduar për periudhën 2002-2006, ATK-ja ka dhënë një përmbledhje të detyrimeve të korporatave, tatimit mbi të ardhurat në vlerë prej 2,536,052 euro si dhe tatimi mbi vlerën e shtuar, të cilat detyrime ende vazhdojnë të regjistrohen në Bilancin e Gjendjes si detyrime të pa ndryshuara, ku ne konsiderojmë se ajo vlerë tani është më e lartë, prandaj mendojmë se detyrimet e prezantuara në pasqyrat financiare nuk paraqesin një gjendje të saktë.



Prishtinë, Kosovë
Mars, 2015

Emri i kompanisë: KRM " PASTRIMI " SH.A
Numri fiskal: 600383989
Adresa: BILL KLINTON
Komuna: PRISHTINË

RAPORTI FINANCIAR VJETOR PËR SHOQËRITË TREGTARE

I. BILANCI I GJENDJES

Më
datën 31.12.2014

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
			Viti vijues	Viti i kaluar
	PASURITË			0.00
A	KAPITALI I THIRRUR I PAPAGUAR			0.00
B	PASURITË JOQARKULLUESE (I+II+III+IV)		5,733,110.24	5,780,566.91
I	PASURITË E PAPREKSHME (1 deri 4)		0.00	0.00
1	Kostot e zhvillimit			
2	Patentat, licencat, markat tregtare, softueri dhe të drejtat tjera			
3	Emri i mirë (Goodwilli)			
4	Pasuritë tjera të paprekshme			
II	PASURITË E PREKSHME (1 deri 7)		5,733,110.24	5,780,566.91
1	Toka		4,745,000.00	4,745,000.00
2	Objektet ndërtimore		531,260.94	575,495.51
3	Pajisjet dhe makineritë		456,849.30	460,071.40
4	Veglat, inventari i repartit dhe mjetet transportuese			
5	Pasuritë biologjike			
6	Pasuritë tjera të prekshme			
7	Investimet në patundshmëri			
III	PASURITË FINANCIARE JOQARKULLUESE (1 deri 6)		0.00	0.00
1	Aksionet tek filialat			
2	Huatë e dhëna ndërmarrësve të ndërlidhur		0.00	0.00
3	Investimet në ortakëri			
4	Investimet në letra me vlerë			
5	Huatë e dhëna, depozitat dhe të ngjashme			
6	Pasuritë tjera financiare joqarkulluese			
IV	PASURITË E SHITYRA TATIMORE			

C	PASURITË QARKULLUESE (I+II+III+IV)		4,732,350.15	4,439,716.07
I	STOQET (1 deri 5)	6.4	42,814.91	33,900.59
1.	Lënda e parë dhe materiali		42,814.91	33,900.59
2.	Prodhimtaria në vijim			
3.	Produktet e gatshme			
4.	Mallrat e listuara në bursë			
5.	Pasuritë tjera qarkulluese për shitje			
II	LLOGARITË E ARKËTUESHME (1 deri 6)		4,253,149.11	4,027,567.96
1.	Llogaritë e arkëtueshme nga filialat			
2.	Llogaritë e arkëtueshme shërbimet	6.2	4,198,881.50	3,967,918.69
3.	Llogaritë e arkëtueshme nga filialet			
4.	Llogaritë e arkëtueshme nga punëtorët			
5.	Llogaritë e arkëtueshme nga shteti dhe institucionet tjera			
6.	Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera	6.3	54,267.61	59,649.27
III	PASURITË FINANCIARE QARKULLUESE (1 deri 6)		1,000.00	3,000.00
1.	Aksionet tek filialat			
2.	Huat e dhëna ndërmarrësve të ndërlidhur			
3.	Investimet në ortakëri			
4.	Investimet në letra me vlerë			
5.	Huat e dhëna, depozitat dhe të ngjashme	6.5	1,000.00	3,000.00
6.	Pasuritë tjera financiare jo qarkulluese			
IV	PARATË NË BANKË DHE ARKË	6.1	435,386.13	375,247.52
E	GJITHSEJT PASURITË (A+B+C+D+E)		10,465,460.39	10,220,282.98
F	ZËRAT JASHTË BILANCORË			
	EKUITETI AKSIONAR, REZERVAT DHE DETYRIMET			
A	EKUITETI AKSIONAR DHE REZERVAT (I+II+III+IV+V+VI+VII)		2,622,492.10	2,606,474.46
I	KAPITALI THEMELUES (I REGJISTRUAR)	7.4	25,000.00	25,000.00
II	KAPITALI REZERVË		0.00	0.00
III	REZERVAT NGA FITIMI (1 deri 4)		0.00	0.00
1.	Rezervat ligjore			
2.	Rezerva për aksionet vetjake			
3.	Rezervat statutore			
4.	Rezervat tjera			
IV	REZERVAT E RIVLERËSIMIT			
V	FITIMET/HUMBJET E BARTURA		2,581,474.46	2,580,092.69
VI	FITIMI APO HUMBJA E VITIT FINANCIAR	7.5	16,017.64	1,381.77

VII	INTERESI MINORITAR			
B	DETYRIMET AFATGJATA (1 deri 8)		0.00	0.00
1	Obligimet ndaj filialave			
2	Obligimet për hua, depozita dhe të ngjashme			
3	Obligimet ndaj bankave dhe institucioneve tjera financiare			
4	Obligimet afatgjata për avance			
5	Llogaritë e pagueshme tregtare		0.00	0.00
6	Obligimet për letra me vlerë			
7	Llogaritë tjera të pagueshme			
8	Detyrimet e shtyra tatimore			
C	DETYRIMET AFATSHKURTA (1 deri 11)		7,842,968.29	7,613,808.52
1	Obligimet ndaj filialave			
2	Obligimet për hua, depozita dhe të ngjashme			
3	Obligimet ndaj bankave dhe institucioneve tjera financiare			
4	Obligimet afatgjata për avance			
5	Llogaritë e pagueshme tregtare	7	2,086,144.03	2,011,493.06
6	Obligimet për letra me vlerë			
7	Llogaritë tjera të pagueshme			
8	Obligimet ndaj të punësuarëve		150,636.32	143,197.26
9	Obligimet për tatime dhe kontribute	7.1,7.3	4,935,206.23	4,789,140.86
10	Obligimet ndaj aksionarëve për dividendë			
11	Obligimet tjera afatshkurta të shtyra	7.6	670,981.71	669,977.34
D	GJITHSEJ EKUITETI AKSIONAR, REZERVAT DHE DETYRIMET (A+B+C+D)		10,465,460.39	10,220,282.98
E	ZËRAT JASHTË BILANCIT			
	<i>Vetëm për Raportet e konsoliduara</i>			
A	EKUITETI AKSIONAR DHE REZERVAT			
1	Iu takon pronarëve të kompanisë mëmë			
2	I takon interesit minoritar			

Gazmend REXHEPI

Shef i Kontabilitetit & financa

Sabri KADRIU

Drejtor Financiar

Felix SALHIU

Krye shef Ekzekutiv

II. PASQYRA E TË ARDHURAVE

Për periudhën 1/1/2014 deri 31.12.14

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
			Viti vijues	Viti i kaluar
I	TE HYRAT (1 deri 3)		5,429,953.61	5,018,217.97
1	Të hyrat nga shitja e shërbimeve	4	5,412,584.19	4,985,562.53
2	Të hyrat nga përdorimi i produkteve, mallrave dhe shërbimeve			
3	Të hyrat tjera afariste	4.1	17,369.42	32,655.44
II	SHPENZIMET (1 deri 7)		5,561,151.66	5,234,177.01
1	Zvogëlimi i vlerës së stoqeve			
2	Shpenzimet direkte për shërbimet e shitura	5	524,000.59	499,714.60
3	Shpenzimet e materialit (a+b+c)			
	a) Materiali dhe mirëmbajtje riparim	5.2	150,094.50	160,277.20
	b) Shpenzimet e administrative	5.3	79,592.83	62,964.00
	c) Shpenzimet e derivateve	5.6	455,372.28	515,650.60
4	Shpenzimet e pagave (a+b)	5.1	2,205,277.66	2,069,326.69
	a) Pagat dhe medijet bruto		2,100,429.12	1,971,307.45
	b) Kontributi për sig.pensionale/Punëdhënës		104,848.54	98,019.24
5	Zhvlerësimi	5.8	247,692.46	325,291.28
6	Shpenzimet tjera	5.7,5.4,5.5	224,130.34	135,379.19
7	Shpenzimet e provizionimit të borxhit të keq		1,674,991.00	1,465,573.45
III	TE ARDHURAT FINANCIARE (1 deri 5)		148,995.43	217,494.34
1	Kamatat, diferencat e kursit, dividendat dhe të ardhurat e ngjashme nga filialat			
2	Kamatat, diferencat e kursit, divid. dhe të ardh. tjerët			
3	Pjesa e të hyrave nga filialat			
4	Fitimi i përcaktuar			
5	Të ardhurat tjera financiare		148,995.43	217,494.34
IV	TË DALAT FINANCIARE (1 deri 4)		0.00	0.00
1	Kamatat, diferencat e kursit, dividendat dhe të ardhurat e ngjashme nga filialat			
2	Kamatat, diferencat e kursit, dividendat dhe të ardhurat e ngjashme nga të tjerët			

3	Humbja e parealizuar			
4	Të dalat tjera financiare			
V	Të ardhurat tjera të pazakonshme			
VI	Të dalat tjera të pazakonshme			
VII	GJITHSEJ TË ARDHURAT (I+III+V)		5,578,949.04	5,235,712.31
VIII	GJITHSEJ SHPENZIMET (II+IV+VI)		5,561,151.66	5,234,177.01
IX	FITIMI PARA TATIMIT (VII-VIII)		17,797.38	1,535.30
X	HUMBJA PARA TATIMIT (VIII-VII)			
XI	TATIMI NË FITIM		1,779.74	153.53
XII	FITIMI NETO (IX-XI)		16,017.64	1,381.77
XIII	HUMBJA E PERIUDHËS (X+XI) ose (XI-IX)			
	<i>Vetëm për Raportet e konsoliduara</i>			
A	FITIMI/HUMBJA E PERIUDHËS		16,017.64	1,381.77
1	Iu takon pronarëve të kompanisë mëmë		16,017.64	1,381.77
2	I takon interesit minoritar			

Gazmend REXHEPI
Shef i Kontabilitetit & financa

Sabri KADRIU
Drejtor Financiar

Feim SALIHU
Krye shef Ekzekutiv

III. PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Për periudhën

01.01.2014-31.12.2014

METODA DIREKTE

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
			Viti vijues	Viti i kaluar
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE				
1	Arkëtimet e parasë nga blerësit		4,282,990.63	4,051,347.53
2	Arkëtimet e parasë nga honoraret, tarifat, komisionet e të ngjashme			
3	Arkëtimet e parasë nga sigurimi për kompensim dëmi			
4	Arkëtimet e parasë nga rimbursimi i tatimit			
5	Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet operative		18,179.38	
I	GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE (1 deri 5)		4,301,170.01	4,051,347.53
1	Pagesat e parasë për furnitorët		1,510,586.91	1,513,837.16
2	Pagesat e parasë për të punësuarit		2,175,466.54	2,071,571.21
3	Pagesat e parasë për sigurimin për kompensimin e dëmeve			
4	Pagesat e parasë për interes		497.19	
5	Pagesat e parasë për tatime		505,411.54	350,232.34
6	Pagesat e tjera të parasë për aktivitetet operative		10,442.90	64,600.62
II	GJITHSEJ PAGESAT E PARASË PËR AKTIVITETET OPERATIVE (1 deri 6)		4,202,405.08	4,000,241.33
A	RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE (I-II)		98,764.93	51,106.20
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE				
1.	Arkëtimet e parasë nga shitja e pasurive jo qarkulluese, të prekshme dhe të paprekshme			
2.	Arkëtimet e parasë nga shitja e pronës dhe instrumenteve të borxhit			
3.	Arkëtimet e parasë nga interesi			
4.	Arkëtimet e parasë nga dividendat			
5.	Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet investuese		150,000.00	285,000.00
III	GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE (1 deri 5)		150,000.00	285,000.00
1.	Pagesat e parasë për blerjen e pasurive joqarkulluese,		188,626.30	291,053.00

	të prekshme dhe të paprekshme			
2.	Pagesat e parasë për blerjen e pronës dhe instrumenteve të borxhit			
3.	Pagesa tjera të parasë për aktivitetet investuese			
IV	GJITHSEJ PAGESAT E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE (1 deri 3)		188,626.30	291,053.00
B	RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE (III-IV)		-38,626.30	-6,053.00
	RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUERE			
1.	Arkëtimet e parasë nga emtimi e instrumenteve financiare të borxhit dhe atyre të ekuitetit			
2.	Arkëtimet e parasë nga kryegjeja e kredisë, fleteobligacionet, huatë dhe huazimet tjera			
3.	Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet financuese			
V	GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUERE (1 deri 3)		0.00	0.00
1.	Pagesat e parasë për pagimin e kryegjës së kredisë dhe fleteobligacioneve			
2.	Pagesat e parasë për dividendat			
3.	Pagesat e parasë për lizingun financiar			
4.	Pagesat e parasë për ri-blerjen e aksioneve vetjake të kompanisë			
5.	Pagesa tjera të parasë për aktivitetet financuese			
VI	GJITHSEJ PAGESAT E PARASË PËR AKTIVITETET FINANCUERE (1 deri 5)		0.00	0.00
C	RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUERE (V-VI)		0.00	0.00
D	RRJEDHA NETO E PARASË (A+B+C)		60,138.63	45,053.20
E	PARATË DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FILLIM TË PERIUDHËS		375,247.52	330,194.32
F	PARATË DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FUND TE PERIUDHËS (D+E)		435,386.15	375,247.52
G	RRITJA (ZVOGËLIMI) I PARASË DHE EKVIVALENTËVE TË PARASË		60,138.63	45,053.20

Gazmend REXHEPI <i>[Signature]</i> Shef i Kontabilitetit & Financa	Sabri KADRIU <i>[Signature]</i> Drejtor Financiar	Feim SALIHU <i>[Signature]</i> Krye shef Ekzekutiv
---	--	---

IV. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

Për periudhën 1/1/2014 deri 31.12.2014

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
			Viti vijues	Viti i kaluar
1	Kapitali i regjistruar		25,000.00	25,000.00
2	Rezervat e kapitalit			
3	Fitimet e mbajtura ose humbjet e akumuluar		2,581,474.46	2,580,092.69
4	Fitimi ose humbja nga viti vijues		16,017.64	1,381.77
5	Rivlerësimi i pasurive jo qarkulluese të prekshme			
6	Rivlerësimi i pasurive jo qarkulluese të paprekshme			
7	Rivlerësimi i pasurive financiare në dispozicion për shitje			
8	Rivlerësime tjera			
Gjithsej kapitali dhe rezervat (1 deri 8)			2,622,492.10	2,606,474.46
9	Diferenca të kursit nga investimet neto në afarizmin në botën e jashtme			
10	Tatimet aktuale dhe të shtyra			
11	Mbrojtja e rrjedhës së parasë			
12	Ndryshimi në politikat kontabël			
13	Korrigjimi i gabimeve materiale nga periudhat paraprake			
14	Ndryshime tjera në ekuitet			
Rritja apo zvogëlimi i tërësishëm në kapital (9 deri 14)			0.00	0.00
<i>Vetëm për Raportet e konsoliduara</i>				
a)	Iu takon pronarëve të kompanisë mëmë			
b)	I takon interesit minoritar			

Gazmend REXHEPI	Sabri Kadriu	Feim Salihu
Shef i Kontabilitetit & Financa	Drejtor Financiar	Krye shef Ekzekutiv

TË PËRGJITHSIME

Shoqëria K.R.M. "PASTRIMI" SH.A. Prishtinë, themelohet në zbatim të Ligjit Nr. 03/L-087, "*Mbi Ndërmarrjet Publike*", Ligjit Nr. 02/L-123, "*Për Shoqëritë Tregtare*" dhe Vendimit të MEF-it nr.218/1 dt.30.09.2009, dhe është trashëgimtare e K.R.M. "PASTRIMI" SH.A. Prishtinë, e themeluar me numër biznesi 70465142 të datës 31.12.2007.

I Komunat e regjionit të Prishtinës, janë pronare të Shoqërisë me kapital publik, sipas përqindjes së aksioneve që posedojnë dhe përfaqësohen nga Komisionet Komunale të Aksionarëve.

Aktivitetet biznesore të kompanisë

Veprimtaria

Veprimtaria e KRM "PASTRIMI"SH.A.-Prishtinë është:

Veprimtaritë primare:

9000 Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të hedhurinave, veprimtarit sanitare e të ngjashme,

9001 Mbledhja e bërllokut, sendeve të shfrytëzuara dhe hedhurinave,

9002 Largimi i mbeturinave me ndezje ose me mënyra tjera

Veprimtaritë sekondare :

9003 Pastrimi dhe larja e rrugëve, trotuareve, parkingjeve etj.,

9004 Largimi i borës dhe akullit duke përfshirë hedhjen e kripës,

9005 Zbrazja dhe pastrimi i gropave septike dhe rezervuarëve dhe servisimi kimik i nevojtove

Veprimtaritë tjera:

3710 Riciklimi i mbeturinave dhe hedhurinave metalike

3720 Riciklimi i hedhurinave dhe mbeturinave jo metalike

5157 Tregtia me shumicë e mbeturinave dhe hedhurinave

7470 Pastrimi i të gjitha llojeve të objekteve

7484 Veprimtari të tjera afariste, p.c,

7511 Veprimtaria e shërbimeve të përgjithshme publike, e

9305 Veprimtari të tjera shërbyese, p.c.

2 PASQYRA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

2.1.Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të adoptuara në Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

2.2.Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në pajtueshmëri me konventën e kostos historike, por njëkohësisht e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në shumat e rivlerësuara. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë konsistente, dhe poqese nuk ceket ndryshe, janë konsistente me ato që janë miratuar në vitin e kaluar financiar.

Përgatitja e pasqyrave financiare konform të SNRF kërkon përdorimin e parashikimeve të shpeshta kritike të kontabilitetit. Gjithashtu kërkojnë menaxhmentit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proceset e aplikimit të politikave të kontabilitetit.

Periudha raportuese e Shoqërisë përfshin një periudhë dymbëdhjetë mujore duke përfunduar me 31 Dhjetor të çdo viti.

Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë krahasuese duke paraqitur në këtë mënyrë saldot për vitin e tanishëm dhe të kaluar.

Sikur vitet paraprake ashtu edhe aktualisht Kompania është e varur nga grantet e dhuruara nga komuniteti vendor dhe ndërkombëtarë, që ti mundësoj Kompanisë të vazhdoj me operimet e saj biznesore në të ardhmen.

2.3.Valuta e këmbimit

Monedha raportuese e KRM "PASTRIMI" SH.A. është njësia monetare e Unionit European (Euro). Transaksionet në monedhat tjera përveç euros janë të regjistruara sipas kursit të këmbimit sipas datave të transaksioneve.

Transaksionet e valutës së huaj konvertohen duke përdorur normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Çfarëdo lloj përfitimesh apo humbjesh, që kanë të bëjnë me harmonizimin e shumave, të pagueshme ose të arkëtueshme, njihen në pasqyrën e të ardhurave.

2.4. Prona, impiantet dhe pajisjet

Vlerësimi i pronës , impianteve dhe pajisjeve të KRM "PASTRIMP" SH.A. është kryer nga vlerësues të pavarur të kualifikuar dhe profesional, ku data efektive e vlerësimit është 01 Janar 2007.

Siç përshkruhet në Raportin e Vlerësimit të Aseteve Pastrimi, ndërtesat përfshijnë ndërtesat regjistruar dhe jo të regjistruara. Nëse veprimet e ardhshme ligjore apo të tjera rezultojnë në regjistrimin e ndërtesave të paregjistruara, regjistrat e asetëve fikse dhe ndërtesat gjat vlerësimit do të duhet të rregullohen në mënyrë të përshtatshme.

Zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve me 01.01.2007 janë bartur sipas koston minus zhvlerësimi i akumuluar. Kosto paraqet shpenzimin që i atribuohet direkt blerjes.

Një zë nga pajisjet dhe makineritë largohet nga bilanci i gjendjes kur shitet ose kur tërhiqet nga përdorimi dhe kur nuk pritet ndonjë benefit i ardhshëm nga ato.

Riparimet dhe mirëmbajtja ngarkohen në pasqyrën operative atëherë kur ndodhin shpenzimet.

Ngarkimi vjetor për amortizimin llogaritet duke përdorur metodën lineare për të gjitha kategoritë e pronës, toka nuk është e zhvlerësuar

Shpenzimet pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të asetit apo janë njohur si asete të ndara , në mënyrën e duhur, vetëm atëherë kur përfitimi ekonomik i mundshëm lidhur me to mund të rrjedhë në Kompani dhe vlera e njetit mund të matet seriozisht.

Shkalla e zhvlerësimit të asetëve sipas përcaktimit të vlerësuesve mbi jetën e përdorimit dallon nga shkalla e zhvlerësimit sipas Rregulloreve në fuqi:

2.5. Zhvlerësimet e asetëve

Prona, impiantet dhe pajisjet rishikohen për dëmtim kurdo që ndonjë ngjarje ose ndryshimet në bazë të rrethanave tregojnë se shumica bartëse e një asemi nuk mund të rikuperohet. Kurdo që vlera bartëse e një asemi e tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme, një humbje nga rënia në vlerë njihen në të ardhura. Vlera e rikuperueshme e një asemi është çmimi më i lartë shitës neto i një asemi dhe vlera në përdorim. Çmimi neto i shitjes është shumica e arritshme nga shitja e një asemi në një transaksion të vullnetit të lirë, përderisa vlera në përdorim është vlera aktuale e paraparë në të ardhmen e flukseve të parashë që pritet të arrijnë nga përdorimi i vazhdueshëm të një asemi dhe nga heqja e tij në fund të jetëgjatësisë së përdorimit të tij. Vlerat e rikuperueshme llogariten për asetet individuale ose, nëse nuk është e mundur, për njësitë që gjenerojë të holla.

2.6. Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme përbëhen nga softuerët për kontabilitet (Link). Këto fillimisht deklarohen sipas koston së tyre dhe më pas sipas koston minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metodën lineare përderisa kostoja e një asemi të paprekshëm shlyhet përgjatë kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit.

2.7. Instrumentet financiare

Asetet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Kompania bëhet pjesë e dispozitave kontraktuese të instrumentit financiar. Asetet financiare nuk njihen kur të drejtat e kontraktuara mbi rrjedhën e parasë nga asetë financiar skadon, ose kur asetë financiar dhe të gjitha rreziqet e konsiderueshme dhe shpërblimet janë transferuar. Detyrim financiar nuk njihet kur ai është shuar, shlyer, anuluar apo skaduar.

Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksioneve, me përjashtim të aseteve dhe detyrimeve financiare të bartura në vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, të cilat fillimisht janë matur me vlerën e drejtë. Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur më pas ashtu si përshkruhet më poshtë.

2.8. Asetet financiare

Kompania klasifikon asetet e saj financiare në këto kategori si në vijim: pasuritë financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kredive dhe të arkëtueshmeve. Menaxhmenti klasifikon investimet e tij në momentin e njohjes së tyre fillestare.

2.9. Mjetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Asetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë asetet financiare të mbajtura për tregji. Aseti financiar klasifikohet në këtë kategori nëse kryesisht është përvetësuar për qëllim shitje në afat të shkurtër. Asetet në këtë kategori janë klasifikuar si asetë qarkulluese. Kompania nuk ka asetë të klasifikuar në këtë kategori deri në datë të raportimit.

2.10. Kreditë dhe të arkëtueshmet

Huat dhe të arkëtueshmet janë asetë financiare jo-derivateve me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Këto janë të përfshira në asetet qarkulluese, me përjashtim të kredive dhe të arkëtueshmet që kanë maturitet në më shumë se 12 muaj që nga data e bilancit të gjendjes. Kreditë dhe të arkëtueshmet e Kompanisë në datën e bilancit të gjendjes përbëhen nga të arkëtueshmet tjera dhe tregtare, paraja dhe ekuivalentët e parasë.

2.11. Stokset

Stokset e KRM "PASTRIMI" SH.A. janë kryesisht materiale dhe pjesët rezervë të cilat janë të lidhura kryesisht me funksionimin e Shërbimit të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të hedhurinave, veprimtaritë sanitare e të ngjashme. Vlera e stokeve është vlerësuar me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme, duke përdorur metodën e matjes mesatare dhe përfshin shpenzimet e kryera në përvetësimin e stokeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin ekzistues dhe gjendjen ekzistuese të tyre. Këto materiale dhe pjesët rezervë fillimisht janë regjistruar në stoke, e më pas janë shpenzuar ose kapitalizuar në momentin e instalimit.

2.12. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë bartur në shumat e faturuara siç janë reduktuar nga provizioni i bërë për dëmin e tyre. Provizioni për borxhet e këqija është vendosur kur ka evidencë objektive se Kompania nuk do të jetë në gjendje ti mbledhë të gjitha shumat e pritura.

2.13. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë mbahen në bilancin e gjendjes sipas kostos. Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë së gatshme, paraja përfshinë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

2.14. Kapitali aksionarë

Kapitali aksionarë përbëhet nga vlera monetare e kontribuar, e regjistruar në librat e Kompanisë në shumën prej 25,000.00€.

2.15. Rezervat

Rezervat fillimisht janë njohur në gjendjen fillestare të bilancit të gjendjes në mes të vlerës reale të pasurive neto dhe vlerës së kapitalit fillestar të kontribuar nga aksionarët e Kompanisë.

2.16. Përfitimet e punëtorëve

Numri i të punësuarve në KRM "PASTRIMI" SH.A. për periudhën 01.01.2014-31.12.2014 ka varruar nga 504 në 496 të punësuar.

Në rrjedhat normale të biznesit, entiteti bënë pagesat në emër të punëtorëve të vetë për kontributet pensionale dhe tatimet në të ardhurat personale të cilat janë të kalkuluar në bazë të pagave bruto sipas legjislacionit në fuqi. Këto shpenzime i ngarkohen pasqyrave të të ardhurave për periudhën e caktuar kohore.

2.17. Tatimi

KRM "PASTRIMI" SH.A. është kërkuar që të paguajë tatim në fitimin e realizuar për çdo periudhë financiare kontabile të kalkuluar në përputhshmëri me Rregulloret në fuqi, për periudhën e caktuar, si dhe tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin dhe kontributet në të ardhura personale.

Sipas legjislacionit aktual tatimor, humbjet e tatimit mundë të barten për tu vendosur në pesë vitet pas vitit kur ka ndodhur humbja.

2.18. Njohja e të hyrave operative

Të hyrat e Kompanisë janë kryesisht të hyra të cilat realizohen nga veprimtaria primare e entitetit – Shërbimit të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të hedhurinave, veprimtarit sanitare e të ngjashme .

Të hyrat njihen kur është e mundur që fitimet ekonomike lidhur me rrjedhën e transaksioneve të Kompanisë dhe kur shumat e të hyrave mund të matet besueshëm dhe kur kriteret për secilin nga aktivitetet e ndryshme të kompanisë janë përmbushur. Këto kritere të njohjes së aktiviteteve-specifike janë të bazuara në mallrat ose zgjidhjet e siguruar ndaj klientit dhe kushteve të kontratës në secilin rast, dhe janë përshkruar më poshtë

Për kontratat materiale, faza e përfundimit është matur në bazë të shpenzimeve të drejtpërdrejta të shkaktuara si një përqindje e shpenzimeve totale që do të ndodhin. Të hyrat nga kontratat me çmime fikse për ofrimin e shërbimeve të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të hedhurinave, veprimtarit sanitare e të ngjashme, në përgjithësi njihen në periudhën që shërbimet janë siguruar, duke përdorur metodën drejtë-vizore mbi afatin e kontratës.

Nëse lind ndonjë rrethanë që mund të ndryshojnë vlerësimin origjinal të të hyrave, kostove ose shkallën e progresit drejt përfundimit, vlerësimet korrigjohen. Këto rishikime mund të rezultojnë në rritje apo zvogëlime në të ardhurat ose shpenzimet e vlerësuara dhe pasqyrohen në të ardhura në periudhën në të cilën rrethanat që shkaktuan iniciimin e rishikimit bëhet i njohur nga menaxhmenti.

2.19. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin e kryerjes së shërbimit ose në datën e faturimit.

2.20. Shpenzimet e huazimit

Shpenzimet e huazimit kryesisht përbëhen nga interesi mbi huazimet e Kompanisë. Të gjitha kostot e huamarrjes, duke përfshirë koston e huamarrjes drejtpërdrejtë i atribuohet përvetësimit, ndërtimit apo prodhimit të një aseti të caktuar, janë shpenzuar në periudhën në të cilën ato janë shkaktuar dhe raportuar në "kostot financiare".

2.21. Grantet qeveritare

Grantet nga qeveria janë njohur me vlerën reale ku është një siguri e arsyeshme se grantet do të merren dhe Kompania do ti përmbush kushtet e bashkangjitura.

Grantet qeveritare lidhur me blerjen e pajisjeve, pronës dhe impianteve janë të përfshira në detyrimet jo qarkulluese si grant qeveritar i shtyrë dhe janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave në bazë drejtvizore sipas shkallës së zhvlerësimit për kategorinë e caktuar.

Grantet qeveritare që lidhen me shpenzimet janë të shtyra dhe njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave gjatë periudhës së nevojshme që të përputhen ato me shpenzimet që ato kanë për qëllim për ti kompensuar.

2.22. Provizionet, detyrimet kontingjente dhe asetet kontingjente

Provizionet njihen kur detyrimet e tanishme si rezultat i një ngjarje në të kaluar mund të çojë në një fluks dalës të burimeve ekonomike nga grupi ku shumat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Koha apo shumat e daljeve mund të jetë ende e pasigurt. Një detyrim i tanishëm lind nga prania e një zotimi konstruktiv ose detyrimi ligjor që ka rezultuar nga ngjarjet e kaluara. Provizionet nuk njihen për humbjet operative në të ardhmen.

Provizionet maten me shpenzimet e parashikuara të nevojshme për të shlyer obligimin e tanishëm, duke u bazuar në dëshmi të besueshme në dispozicion në datën e raportimit, duke përfshirë rreziqet dhe pasiguritë lidhur me detyrimin e tanishëm. Aty ku ka një numër të detyrimeve të ngjashme, gjasat që një fluks dalës do të kërkohej në shlyerje të obligimit përcaktohet duke marrë në konsideratë klasën e detyrimeve si tërësi. Provizionet zbriten në vlerën e drejtë të tyre, kur vlera kohore e parasë është materiale.

Të gjitha provizionet rishikohen në çdo datë të raportimit dhe rregullohen për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual.

Detyrimet kontingjente

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen vetëm nëse mundësia e një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët.

Si detyrim kontingjent shpalosen paditë për konteste pune, kompensime të dëmit për prona, për borxhe etj.

Këto detyrime nuk janë rishikuar në datë të raportimit për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual.

Shuma e një humbje kontingjente njihet si provizion nëse ka gjasat që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë që, një detyrim ka ndodhur deri në datën e bilancit të gjendjes dhe një vlerësim i arsyeshëm i humbjes së shkaktuar mund të bëhet.

Pasuritë kontingjente

Një pasuri kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloset kur një fluks hyrës i përfitimeve ekonomike është i mundshëm.

Si pasuri kontingjente shpalosen kërkesat e mundshme. Këto provizione nuk janë rishikuar në datë të raportimit për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual.

3. Menaxhimi i riskut financiar dhe kapital

Menaxhmenti i riskut të Kompanisë përbëhet nga Bordi i drejtorëve..

Objektivat e Kompanisë kur menaxhojnë me kapital janë të ruajnë mundësinë që Kompania të vazhdoj me punë në të ardhmen.

3.1. Risku kreditor

Mjetet financiare të cilat e vënë Kompaninë në risk kreditor përbëhen prej parasë në dorë dhe parasë në llogaritë bankare.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë të Kompanisë përbëhen kryesisht nga salldot bankare. Kompania ka depozita, mjete në llogari të kursimit në ekuivalente të parasë në institucione financiare ku risku i humbjes konsiderohet i vogël.

3.2. Analiza e riskut të kredisë

Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë është i kufizuar në vlerën bartëse të aseteve financiare të njohura në datën e raportimit, të përmbledhura si më poshtë:

	31.12.2013	31.12.2014
Të arkëtueshmet dhe të tjera		
Të arkëtueshmet tregtare	3,967,492.20	4,198,881.50
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	375,247.52	435,386.13
Total	4,342,839.72	4,634,267.63

3.3. Risku i likuiditetit

Kompania menaxhon nevojat e saj të likuiditetit duke monitoruar kujdesshëm pagesat e borxheve për detyrimet financiare afatgjate, si dhe hyrjet e parave të parashikuara dhe daljet e parasë nga aktivitetet e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditetin monitorohen në kohë të ndryshme, Kërkesa neto e parave krahasohet me mundësitë në dispozicion të huamarrjes në mënyrë që të përcaktoj ndonjë tepriçë apo ndonjë mungesë. Kjo analizë tregon se mundësitë e huamarrjes në dispozicion pritet të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës në vërtetim.

	31.12.2013	31.12.2014
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	2,011,493.06	2,086,863.90
Huamarrjet	0.00	0.00
Totali	2,011,493.06	2,086,863.90

3.4. Instrumentet financiare sipas kategorive

Vlerat bartëse të aseteve dhe detyrimeve financiare të kompanisë të njohura me datën e bilancit të gjendjes të periudhës raportuese nën vështrim gjithashtu mund të kategorizohet si në vijim:

Asetet financiare

Kreditë dhe të arkëtueshmet	31.12.2013	31.12.2014
Llogaritë e arkëtueshme	3,967,492.20	4,198,881.50
Paraja dhe ekuivalentët e saj	375,247.52	435,386.13
Totali	4,342,739.52	4,634,267.63

Detyrimet financiare

Huazimet qarkulluese	0.00	0.00
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	2,011,493.06	2,086,863.90
Total	2,011,493.06	2,086,863.90

4. Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 31 Dhjetor 2014, janë:

	31.12.2013	31.12.2014
Paraja në bankë dhe llogari rrjedhëse	374,738.69	432,938.63
Paraja në arkë	508.83	2,447.50
Totali i parasë në arkë dhe bankë	375,247.52	435,386.13

Kompania ka të hapura 7 llogari bankare , 1 arkë qendrore dhe 3 arka regjionale.

5. Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera me 31 Dhjetor 2014, janë:

Sektorët	31.12.2013	31.12.2014
Sektori i amvisërisë	11,338,578.01	12,473,043.67
Sektori komercial	4,840,748.36	5,026,410.45
Sektori institucior	1,602,453.77	1,605,967.56
Me kontrata	1,046,743.00	1,126,180.16
Totali:	18,828,523.14	20,231,601.64
Provizionimet	-14,861,030.94	-16,032,720.30
Neto llog. Ark.	3,967,492.20	4,198,881.50

6. Stoqet

	31.12.2013	31.12.2014
Stoqet e pjesëve rezervë	831.78	13,613.89
Stoqet e materialit hargjues	8,502.36	3,349.78
Stoqet e materialit zyrtar	4,716.41	2,580.68
Stoqet e inventarit te imët	120.61	589.58
Stoqet e derivateve	9,501.34	6,617.69
Stoqet e mbrojtjes në punë	434.31	2,997.21
Stoqet e autogomave	7,158.30	11,254.85
Vajrat	2,635.48	1,811.23
Total stoqet	33,900.59	42,814.91

7.Asetet

ASETET	paimet, makinat	ndërtesat	toka	total
Kosto historike 01.01.2013	1,760,441.30	884,751.41	4,745,000.00	7,390,192.71
Shtesat gjat vitit	200,235.81	0.00	0.00	0.00
Gjithsejtë	1,960,677.11	884,751.41	4,745,000.00	7,590,428.52
Heqjet/shitjet				
Zhvlerësimi i grumbulluar	-1,300,369.83	-309,255.90		1,609,625.73
Zhvlerësimi i vitit	-203,457.89	-44,240.57		-247,695.46
Total asetet me 31.12.2014	456,849.39	531,260.94	4,745,000.00	5,733,110.33

Shtesat apo blerjet e reja gjat periudhës 01.01.2014-31.12.2014 janë në vlerë prej 200,235.81 euro.

8. Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

	31 .12. 2013	31.12.2014
Të pagueshmet tregtare		
KLMC-Deponia/Prishtine/Podujeve	1,513,024.34	1,627,075.56
Furnitorët lokal	296,000.75	256,600.50
Të pagueshmet tjera afatshkurtra/Zrrum	202,467.97	202,467.97
Totali i të pagueshmeve tregtare dhe të tjera	2,011,493.06	2,086,144.0

9. Grantet e shtyera

	31.12.2013	31.12.2014
Me 01 Janar	602,471.68	669,977.34
Grantet e fituara gjatë vitit	285,000.00	150,000.00
Gjithsejtë grantet	887,471.68	819,977.00
Të hyrat e njohura nga grantet e shtyera	(217,494.34)	148,995.40
Total	669,977.34	670,981.60

Total vlera e granteve te zhvlerësuar dhe te njohura si te hyra është 217,494.34euro, ndersa vlera e mbetur si detyrim/e hyrë e shtyer është 669,977.34euro.

10. Të hyrat operative

	31 .12. 2013	31.12.2014
Të hyrat nga amvisëritë	2,848,710.49	2,979,426.00
Të hyrat nga komercialet	475,762.20	457,029.80
Të hyrat nga institucionet	302,853.55	265,493.53
Të hyrat nga kontratat	1,358,236.29	1,240,717.00
Të hyrat nga inkasomi i borxheve te vjetra nga Lokalet		50,487.80
Të hyrat nga inkasomi i borxheve te vjetra nga Amvisëria		419,430.05
Total të hyrat operative	4,985,562.53	5,412,584.19

10.1. Të hyrat tjera	31.12. 2013	31 Dhjetor 2014
Të hyrat nga interesi	6,437.48	332.40
Të hyrat tjera	9,752.99	17,037.02
Të hyrat nga grantet	217,494.34	148,995.76
Te hyrat nga shitja e asetëve	16,464.97	
Total të hyrat tjera	250,149.78	166,365.18
Total të hyrat	5,235,712.31	5,428,949.37

11.Shpenzimet e shërbimeve të ofruara

	31.12.2013	31.12. 2014
Shpenzimet e deponisë	451,355.91	502,928.84
Shpenzimet e marrëveshjes së nënkontraktorëve	42,729.11	21,071.75
Shpenzimet e kripës industrial	4,837.56	
Shpenzimet e rërës	792.00	
Gjithsejt Shpenzimet e shërbimeve të ofruar	499,714.60	524,000.59

12. Shpenzimet e personelit

	31.12.2013	31.12.2014
Pagat	1,955,728.46	2,086,744.86
Kontributet e detyrueshme	98,019.24	109,848.54
Pagat e Bordit	15,578.99	13,684.26
Total shpenzimet e pagave	2,069,326.69	2,205,277.66

Numri i punëtorëve me 01 Janar ishte 504 të punësuar , ndërsa me 31.12.2014 ishte 496 të punësuar.

13. Shpenzimet e mirëmbajtjes

	31.12.2013	31.12.2014
Shpenzimet e riparimeve	36,650.01	31,614.00
Shpenzimet e materialit hargjues	81,494.18	46,285.19
Shpenzimet e inventarit të imët	1,243.82	3,846.65
Shpenzimet e autogomave	25,318.19	33,240.31
Mbrojtja	1,998.95	8,888.82
Mirëmbajtja direkte e automjeteve	13,572.02	26,219.53
Gjithsejtë Shpenzimet e mirëmbajtjes	160,277.17	150,094.50

14. Shpenzimet administrative

	31.12.2013	31.12.2014
Shpenzimet e reklamës	115.30	254.00
Shpenzimet e internetit	1,012.10	2,808.11
Shpenzimet softuerike	4,482.28	
Provizionet bankare	4,167.73	3,111.71
Shpenzimet e sigurimeve të automjeteve	26,142.64	35,683.04
Shpenzimet e PTK-së	10,022.93	8,637.52
Shpenzimet e materialit zyrtar	6,775.11	11,700.00
Shpenzime tjera administrative	7,082.68	13,738.94
Kontrolli teknik i automjeteve	3,163.53	3,659.46
Gjithsejtë shpenzimet administrative	62,964.00	
79,592.83		

15. Shpenzimet operative

	31.12.2013	31.12.2014
Shpenzimet e ujit		
Shpenzimet gjyqësore	7,203.00	16,450.19
Shpenzimet e taksave	15,529.00	50,754.35
Shpenzimet për dhurata	20,700.00	55,610.00
Shpenzimet për mëditje dhe reprezentacion	5,171.06	6,359.77
Shpenzimet e tjera	52,693.55	62,610.96
Shpenzimet për mirëmbajtje	8,667.50	8,950.27
Shpenzimet e energjisë		18,434.80
Gjithsejtë shpenzimet operative	109,964.11	219,170.34

Fushëveprimi- Objektivat dhe shtrirja e auditimit

Auditimi është përformuar në harmoni me SNA. Standardet e përmendura kërkojnë që ne të planifikojmë dhe ekzekutojmë auditimin në mënyrë që të nxjerrët një siguri e arsyeshme se gjendjet e prezantuara në Pasqyrat Financiare nuk kanë pasur keq pohime materiale apo ndryshime. Auditimi jonë përmban hulumtimin e informatave të mbledhura të rëndomta për të vërtetuar shumat dhe informatat e prezantuara në raportin financiar. Po ashtu përmban hulumtimin dhe mendimin mbi politikat e kontabilitetit të cilat janë aplikuar, duke i dhënë rëndësi të veçantë, se si janë bërë ato nga menaxhmenti, dhe hulumtimin mbi prezantimin gjeneral të kontove të shoqërisë.

Sigurimi i dëshmive dhe testeve gjatë procesit të Auditimit

Në KRM "PASTRIMP" SH.A. kemi kryer një sërë testesh përmes mostrave të dëshmive autentike. Punën e testimit dhe sigurimit të dëshmive kryesisht e kemi zhvilluar me ndihmën e stafit të entitetit ku do të prezantojmë disa prej dëshmive dhe mostrave të zgjedhura nga arkivi i librave të kontabilitetit dhe dokumentacionit tjetër që janë shfrytëzuar gjatë auditimit.

- Statuti i entitetit
- Rregulloret
- Manuallet
- Marrëveshja në mes të entitetit dhe të punësuarve të rregullt dhe kontraktorëve/
- Dokumentet e kontabilitetit të cilat janë subjekt i auditimit
- Pasqyrat financiare dhe të aktiviteteve lidhur me entitetin
- Çdo dokument tjetër i cili ka të bëjë me entitetin

Njohja dhe vlerësimi i kontrollit të brendshëm dhe sistemit të kontabilitetit

- Kemi zgjedhur strategjinë e mosbesimit apo (testeve të pavarura) në kontrollin e brendshëm. Kemi bërë biseda me nivelin e duhur të menaxhmentit, mbikëqyrësve dhe personelit tjetër, inspektimi i dokumentacionit, raporteve dhe dosjeve elektronike. Kemi vëzhguar aplikimin e kontroleve të veçanta të brendshme.
- Gjatë procedurave audituese, në bazë të asaj që kemi arritur të shohim, mund të konstatojmë se këtu kontrollohen raportet financiare nga disa nivele duke filluar nga kontabilistët, mbikëqyrësit, menaxherët dhe bordi drejtues.